EDUKIMI PËRMES KUJTESËS HISTORIKE

Roli i AIDSSH-së në formimin e qytetarisë demokratike dhe ndërgjegjësimin e brezave të rinj

Dr. Ornela Arapi

24 nëntor 2026

Pse edukimi përmes kujtesës historike?

Njohja e së kaluarës nuk është vetëm kujtesë e ngjarjeve; është kuptim i mekanizmave që ndikojnë te jeta e individit dhe shoqërisë.

NJOHJA

Të kuptojmë sistemin, ideologjinë dhe mënyrën si u organizua kontrolli mbi shoqërinë.

ANALIZA

Të shqyrtojmë survejimin, represionin, censurën, përndjekjen dhe kufizimin e lirive.

PËRVOJA NJERËZORE

Të shohim historinë përmes jetëve, zgjedhjeve, qëndresës dhe dinjitetit njerëzor.

REFLEKTIMI

Të lidhim faktet historike me pyetjet dhe përgjegjësitë e së sotmes.

Qëllimi nuk është të japim një përgjigje të gatshme për të kaluarën, por të krijojmë kushtet që të rinjtë të pyesin, të kërkojnë prova dhe të formojnë gjykimin e tyre.

Historia e diktaturës si përvojë konkrete e edukimit demokratik

Periudha 1944–1991 ofron raste konkrete për të kuptuar vlerat që mbrojnë një shoqëri demokratike.

LIRITË DHE TË DREJTAT

Liria e shprehjes, e ndërgjegjes, e besimit dhe e mendimit ndryshe.

SHTETI I SË DREJTËS

Pasojat e pushtetit të pakufizuar dhe mungesës së garancive ligjore.

MENDIMI KRITIK

Dallimi i faktit nga interpretimi, i propagandës nga informacioni dhe i manipulimit nga e vërteta.

PËRGJEGJËSIA QYTETARE

Lidhja mes njohjes së së kaluarës dhe përgjegjësisë për të mbrojtur demokracinë sot.

Roli i AIDSSH-së: nga e drejta për të ditur te përgjegjësia edukative

Edukimi qytetar është dimension i përgjegjësisë publike të institucionit, krahas administrimit dhe aksesit në dokumente.

INFORMIM

Kontribut në të drejtën për të ditur dhe në njohjen e së kaluarës.

KËRKIM SHKENCOR

Nxitje e njohurive të verifikuara dhe reflektimit të mbështetur në fakte.

EDUKIMI QYTETAR

Aktivitete, botime, ekspozita dhe projekte që afrojnë të rinjtë me historinë.

KUJTESË PUBLIKE

Transmetim i kujtesës përmes dëshmive, vendeve dhe produkteve dokumentare.

AIDSSH nuk zëvendëson shkollën dhe as institucionet përgjegjëse për kurrikulën. Kontributi i tij është të sigurojë burimin historik, saktësinë dhe kontekstin dokumentar.

Nga nismat te një portofol i strukturuar edukativ

Një proces që ka kaluar nga krijimi i bazës së bashkëpunimit drejt zgjerimit të programeve dhe mjeteve edukative.

2021

Baza institucionale

Marrëveshja me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 18 mars 2021.

2023

Projekti digjital

Prezantimi i projektit “Të mësojmë mbi të shkuarën – burime arsimore të hapura 1944–1991”.

2024–2025

Zgjerimi i programeve

Klubet e Librit, Turi i Leximit, konkursi kombëtar, Arkivi i Hapur dhe Klubi i Filmit.

2026

Thellimi i partneritetit

Bashkëpunimi me ASCAP-in për lidhjen e burimeve historike me mjedisin pedagogjik.

Dokumentimi arkivor → kërkimi shkencor → kujtesa historike → edukimi qytetar

Si e kthen AIDSSH burimin historik në përvojë mësimore?

Burimi arkivor nuk paraqitet i shkëputur; ai shoqërohet me kontekst, shpjegim dhe pyetje që nxisin analizën.

1 · BURIMI

Dokumente, dëshmi, fotografi, materiale audiovizuale dhe botime.

2 · KONTEKSTI

Shpjegimi i rrethanave historike, institucioneve dhe mekanizmave të represionit.

3 · PËRPUNIMI

Përzgjedhje dhe përshtatje e materialit për audienca dhe mosha të ndryshme.

4 · REFLEKTIMI

Pyetje, diskutim, krahasim, interpretim dhe lidhje me të drejtat e njeriut.

Parimi themelor: dokumenti është pikënisje për të kuptuar historinë, jo një material që duhet lexuar pa udhëzim apo kontekst.

Një portofol formatesh që e afron historinë me të rinjtë

Formate të ndryshme, me një synim të përbashkët: kalimi nga njohja pasive te pjesëmarrja dhe reflektimi.

KLUBI I LIBRIT

Lexim dhe diskutim mbi përndjekjen, qëndresën dhe jetën nën diktaturë.

TURI I LEXIMIT

Takime në shkolla, prezantime botimesh dhe bashkëbisedime me nxënësit.

KLUBI I FILMIT

Filmi si pikënisje për njohje, pyetje dhe reflektim.

ARKIVI I HAPUR

Vizita në arkiv, leksione dhe njohje me dokumentacionin e periudhës.

EKSPOZITA DHE VENDET E KUJTESËS

Përballje me histori, figura, ngjarje dhe vende konkrete të vuajtjes.

DËSHMITË GOJORE

Takim me përvojën njerëzore dhe kujtesën e të mbijetuarve.

Turi i Leximit: nga botimi te dialogu me nxënësit

Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës dhe institucionet arsimore e shtriu programin në shkolla dhe qytete të ndryshme.

16 TAKIME

2024–2025

10 QYTETE

Përfshirë Tiranën, Durrësin, Kavajën, Shkodrën, Elbasanin, Përrenjasin, Bulqizën dhe Vlorën.

520 NXËNËS

Pjesëmarrës në takimet e raportuara.

30 MËSUES

Të përfshirë në veprimtari.

Përmbajtja e takimeve u lidh me të drejtat e njeriut, kampin e Spaçit, kalimin e kufirit dhe historitë e përndjekjes, duke përdorur botimet e AIDSSH-së si pikënisje për bisedë dhe reflektim.

Në kuadër të programit u zhvillua edhe konkursi kombëtar: 80 punime të përzgjedhura nga 106 nxënës – ese, tregime, poezi dhe arte pamore.

Klubet e Librit, Klubi i Filmit dhe Arkivi i Hapur

Tre mënyra të ndryshme për të punuar me të njëjtën histori: përmes tekstit, imazhit dhe burimit dokumentar.

KLUBI I LIBRIT

10 takime dhe 446 pjesëmarrës të raportuar për 2024–2025; programi vijoi me 4 klube dhe 117 pjesëmarrës në janar–gusht 2026.

KLUBI I FILMIT

I çelur në nëntor 2025 në bashkëpunim me AQSHF-në; 3 takime, 2 filma dhe 265 pjesëmarrës të raportuar për 2025.

ARKIVI I HAPUR

16 takime dhe 574 pjesëmarrës të raportuar për 2024–2025; në janar–gusht 2026 u raportuan 3 vizita me 75 pjesëmarrës.

Formati e nxjerr historinë nga faqja e librit: nxënësi diskuton, sheh, pyet, njihet me dokumentin dhe kupton se si ndërtohet një njohuri e mbështetur në burime.

Botimet dhe produktet audiovizive si mjete edukimi

Produktet edukative krijojnë ura komunikimi mes historisë së dokumentuar, shkollës dhe përvojës njerëzore.

BOTIME

"Dielli lind në Spaç", "Kufij të thyer" dhe "Spaç, historia e një revolte" – pikënisje për lexim, diskutim dhe njohje të historive të përndjekjes dhe qëndresës.

FILM

"3 ditët e lirisë në Spaç" – produkt audiovizual i menduar posaçërisht për arsimin parauniversitar.

DOKUMENTAR

"Ana tjetër e Valiasit" – pasuron fondin audiovizual dhe ndihmon njohjen e historisë përmes një vendi konkret të vuajtjes.

Botimi, filmi dhe dokumentari nuk janë thjesht produkte komunikimi: ato mund të përdoren si materiale për orë mësimore, klube leximi, diskutime dhe veprimtari përkujtimore.

“Mësojmë nga e kaluara: Burime të hapura arsimore

PËR MËSUESIT

Burime, analiza, dosje tematike dhe udhëzime që mund të mbështesin përgatitjen e orës mësimore.

PËR NXËNËSIT

Materiale të përshtatura sipas moshës, përmbajtje vizuale dhe veprimtari që nxisin kuriozitetin.

ÇFARË LIDH?

Burimet historike, përmbajtjen shkencore, metodologjinë pedagogjike dhe veprimtaritë në shkolla.

Projekti synon të lidhë burimet historike, përmbajtjen shkencore dhe mjetet pedagogjike në një mjedis të përdorshëm nga mësuesit dhe nxënësit.

Mediateka, fototeka dhe faqet tematike: zgjerimi i aksesit

SPAC.AL DHE KAMPITEPELENES

Informacion historik, profile dhe përmbajtje që e lidhin publikun me vende dhe histori konkrete.

MEDIATEKA

Përpunimi dhe strukturimi i materialeve fotografike e audiovizuale si burime për informim dhe edukim.

RRJETET SOCIALE DHE KANALI YOUTUBE

Postime, video dhe materiale që zgjerojnë komunikimin me publikun dhe brezat e rinj.

Këto mjete e bëjnë kujtesën më të qasshme, por kërkojnë përzgjedhje, përshkrim, kontekstualizim dhe standarde të qëndrueshme të cilësisë historike.

Edukimi & partneriteti: secili institucion sjell ekspertizën e tij

Bashkëpunimi ndërinstitucional lidh saktësinë historike me përshtatshmërinë pedagogjike dhe nevojat reale të shkollës.

AIDSSH · PËRMBAJTJA HISTORIKE

Burimet dhe dokumentacioni; ekspertiza shkencore; botimet dhe produktet edukative; veprimtaritë me nxënës e mësues.

ASCAP · PËRSHTATJA PEDAGOGJIKE

Ekspertiza metodologjike; lidhja me kurrikulën; mbështetja për mësuesit dhe vlerësimi i përshtatshmërisë didaktike.

SHKOLLAT · PËRDORIMI NË MËSIM

Përfshirja sipas nevojave të shkollës; veprimtari mësimore; pyetje, diskutim dhe reflektim me nxënësit.

Marrëveshje me Ministrinë e Arsimit (2021),
Marrëveshje me ASCAP (2026)

Si dhe,
Partneritetet me rreth **25 institucione** të kërkimit shkencor dhe edukimit.

Nga aktiviteti te ndikimi: çfarë duhet të konsolidojmë?

Përvoja e deritanishme krijon bazë të mirë; sfida është ta kthejmë në proces të qëndrueshëm, të matshëm dhe të integruar me shkollën.

MATERIALE TË PËRDORSHME

Mësuesit kanë nevojë për burime të përzgjedhura, kontekstualizuara dhe të përshtatura me moshën.

FORMIM PROFESIONAL

Nevojitet mbështetje për trajtimin e kësaj periudhe me saktësi historike dhe qasje pedagogjike.

VAZHDIMËSI DHE SHTRIRJE

Nga aktivitetet e veçuara te kalendari i përbashkët, shkollat partnere dhe përgjegjësitë e qarta.

VLERËSIM I REZULTATEVE

Përtej numrit të pjesëmarrësve: reagimet, përdorimi i materialeve dhe rezultatet e të nxënit.

Prioritetet për fazën e ardhshme të bashkëpunimit

Një agjendë e përbashkët për ta lidhur më ngushtë kujtesën historike me procesin mësimor.

1. **Program i përbashkët trajnimi për mësuesit** — Me module të përgatitura dhe mbështetje metodologjike.
2. **Paketa burimesh dhe materialesh didaktike** — Dokumente të kontekstualizuara, dëshmi, video, fletë pune dhe udhëzues.
3. **Shkolla partnere dhe vizita studimore** — Vizita në arkiv, klube libri e filmi, takime me dëshmi dhe veprimtari në shkolla.
4. **Mjete digjitale dhe vende të kujtesës** — Burime të hapura, harta interaktive, ture virtuale dhe kronologji digjitale.
5. **Kalendari dhe vlerësimi i përbashkët** — Objektiva, afate, përgjegjësi dhe tregues të matshëm.

Nga dokumenti historik
te qytetari i përgjegjshëm.

Në një dekadë, AIDSSH ka ndërtuar ura ndërmjet dokumentit historik, kërkimit shkencor, shkollës dhe publikut. Hapi i ardhshëm është t'i bëjmë këto ura pjesë të një procesi të qëndrueshëm edukimi.

FALEMINDERIT!